

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE E SEKTORIT TË SIGURISË DHE ÇËSHTJET GJINORE

PËRMBAJTJA

Pse janë çështjet gjinore të rëndësishme për mbikëqyrjen parlamentare?

Si mund të integrohen çështjet gjinore në mbikëqyrjen parlamentare?

Sfidat dhe mundësitë në vendet e post konfliktit

Pyetjet për mbikëqyrjen parlamentare

Informata shtesë

Ekziston një njohje e fuqishme se reforma e sektorit të sigurisë (RSS) duhet të plotësoj nevojat e ndryshme të sigurisë për burra, gra, djem dhe vajza. Integrimi i çështjeve gjinore është po ashtu faktor kyç për efikasitetin dhe përgjegjësinë e sektorit të sigurisë, si dhe për pronësinë vendore dhe legjitimitetin në proceset e RSS.

Ky Shënim Praktik ofron një hyrje të shkurtër për të mirat që dalin nga integrimi i çështjeve gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë, si dhe ofron informata praktike se si të bëhet kjo.

Ky Shënim Praktik bazohet në një mjet më të gjatë, dhe që të dy janë pjesë e **Mjetit Praktik për Çështje Gjinore dhe RSS**. I dizajnuar për të ofruar një hyrje në çështjet gjinore për praktikuesit e RSS dhe politik-bërësit, mjeti praktik përfshin 12 mjete me shënime praktike korresponduese-sih **Më shumë informata**.

Pse janë çështjet gjinore të rëndësishme për mbikëqyrjen parlamentare?

Mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë: 'Legjislatura kryen mbikëqyrje parlamentare përmes kalimit të ligjeve të cilat rregullojnë dhe definojnë shërbimet e sigurisë dhe autorizimet e tyre si dhe duke miratuar alokimet adekuate buxhetore. Një kontroll i tillë mund të përfshijë po ashtu krijimin e një Ombudspersoni ose të ndonjë komisioni i cili do të mund të iniciojë hetime në ankesat e parashtruara nga publiku.¹

Gjinia i referohet roleve dhe marrëdhënieve tipareve të personalitetit, qëndrimeve sjelljeve dhe vlerave të cilat shoqëria ua atribuon burrave dhe grave. Prandaj 'gjinia' i referohet diferencave të mësuara mes burrave dhe grave përdorura 'seksi' i referohet diferencave 'biologjike' mes meshkujve dhe femrave. Rolet e gjinive ndryshojnë shumë nëpër kultura dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Gjinia nuk i referohet thjeshtë vetëm grave apo burrave por edhe marrëdhënieve mes tyre.

Integrimi i çështjeve gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë mund të ndihmojë në krijimin e politikave dhe institucioneve të sigurisë të përgjegjshme, efektive dhe të barabarta:

Politika të sigurisë, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në nevoja

- Parlamentarët, si përfaqësues të zgjedhur të elektoratit të caktuar, kanë përgjegjësi të sigurojnë që nevojat e sigurisë për gra, burra, djem dhe vajza janë të inkorporuar në bërjen e politikave të sigurisë. Për shembull, dhuna e bazuar në gjini (GBV) duke përfshirë trafikimin me njerëz, dhunën intime mes partnerëve, fyerjet seksuale dhe dhunën kundër homoseksualëve, është një nga kërcënimet më të mëdha të sigurisë njerëzore në tërë botën.
- Proceset politikbërëse pjesëmarrëse të cilat përfshijnë një spektër të gjerë të aktorëve të shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat e grave, ndihmojnë në sigurimin e konsensusit publik për prioritetet e sigurisë dhe shtimin e përgjegjësisë dhe legjitimitetit të politikave të sigurisë, institucioneve të sigurisë dhe vetë parlamentit.

Institucionet efektive operacionale të sektorit të sigurisë

- Parlamentet mund të marrin masa për të rritur pjesëmarrjen e grave në sektorin e sigurisë dhe në pozita relevante të qeverisë, gjë që ka rezultuar në një sërë përfitimesh operacionale.
- Parlamenti luan rol thelbësor në parandalimin dhe në mbajtjen e institucioneve të sektorit të sigurisë të përgjegjshme për diskriminim, abuzime seksuale dhe shkelje të drejtave të njeriut.

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull «Toolkit on Gender and Security Sector Reform» nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Dokumenti i bardhë i vitit 1996 mbi Mbrojtjen Nacionale për Republikën e Afrikës së Jugut u hartua nga Laurie Nathan nga Universiteti Kape Town. Projekti i parë i këtij dokumenti u komentua shumë nga organizatat e shoqërisë civile dhe anëtarët e industrisë së mbrojtjes. Ky dokument fokusohet në sigurinë njerëzore dhe thekson krijimin e një kulture institucionale jo-seksiste, duke përfshirë obligimin e Ministrisë së Mbrojtjes për të identifikuar dhe eliminuar praktikën dhe qëndrimet diskriminuese në forcat e armatosura. Përveç kësaj, ky dokument fton për masa afirmative dhe programe me mundësi të barabarta si dhe pranimin e të drejtës së grave për të shërbyer në të gjitha rangjet dhe pozitat, duke përfshirë rolet ushtarake.

Dokumenti i bardhë po ashtu fton për shqyrtim të mbrojtjes për të planifikuar detallet operacionale si doktrina, dizajni i forcave, logjistika, armatimet, resurset njerëzore dhe pajisjet. Me insistimin e grave parlamentare, Komisioni i Përbashkët Parlamentar për Mbrojtje bëri ftesë për konsultime nacionale si pjesë e procesit të shqyrtimit të mbrojtjes. Një sërë masash të ndryshme u ndërmorën për të siguruar pjesëmarrjen publike, duke përfshirë përdorimin e aeroplanëve dhe autobusëve ushtarak për të transportuar liderët religjioz dhe të komuniteteve, aktivistët e OJQ-ve dhe përfaqësuesit e organizatave të grave deri tek takimet rajonale dhe punëtoritë e ndryshme.

Organizatave themelore të grave ishin vitale në ngritjen e çështjeve të injoruara më herët siç janë ndikimi mjedisor i ushtrisë dhe ngacmimet seksuale të grave nga personeli ushtarak. Si përgjigje ndaj këtyre çështjeve, u formuan dy nën-komisione të reja brenda Sekretariatit të Mbrojtjes. Së fundi, natyra pjesëmarrëse e shqyrtimit të mbrojtjes u akreditua duke asistuar procesin e ndërtimit të konsensusit nacional rreth çështjeve të mbrojtjes dhe gjenerimit të legjitimitetit për strukturat e reja të sigurisë.

Vendim marrja parlamentare reprezentative

- Një numër më i barabartë i femrave dhe meshkujve parlamentarë, duke i përfshirë ata në komisionet për mbrojtje dhe siguri, mund të forcojë legjitimitetin dhe barazinë e parlamentarëve. Globalisht, në vitin 2007, 82.6% e parlamentarëve ishin burra.²

Buxhetimi i barabartë dhe menaxhimi i resurseve

- Analizat gjinore të menaxhimit të buxheteve dhe resurseve mund të forcojnë transparencën, përgjegjësinë dhe shpërndarjen e barabartë të fondeve në adresimin e nevojave të sigurisë për burra, gra, vajza dhe djem.

Pajtueshmëria me obligimet që dalin nga ligjet dhe instrumentet ndërkombëtare

Integrimi i çështjeve gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë është i domosdoshëm për të qenë në përputhje me ligjet rajonale dhe ndërkombëtare, instrumentet dhe normat lidhur me sigurinë dhe çështjet gjinore. Instrumentet kyçe përfshijnë:

- *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave* (1979)

- *Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim* (1995)

Për më shumë informata, ju lutem shihni Aneksat e Mjetit Praktik për Ligjet dhe Instrumentet Rajonale dhe Ndërkombëtare.

Si mund të integrohen çështjet gjinore në mbikëqyrjen parlamentare?

Sfidat dhe mundësitë e veçanta që përfshijnë mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë dallojnë mes vendeve të ndryshme, prandaj sugjerimet e mëposhtme për integrimin e çështjeve gjinore duhet t'i adaptohen kontekstit të vendit specifik:

Të krijohen politika të sigurisë, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në nevoja

■ Proceset pjesëmarrëse

- Të zbatohen konsultime të gjera publike për politikën e sigurisë duke përfshirë organizatat e grave dhe të burrave.
- Të krijohen mekanizma për debate publike, siç janë dëgjimet publike.
- Parlamentarët individual mund ta vënë vetën e tyre në dispozicion për të dëgjuar shqetësimet e paraqitura nga

organizatat urbane dhe rurale të grave.

■ Politikën e sigurisë që i përgjigjen çështjeve gjinore

- Të përfshihet përmbajtja që ka të bëjë me çështje gjinore si për shembull trajtimi i GBV dhe promovimi i pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në institucionet e sigurisë.
- Të përdoret sipas nevojës gjuha gjithëpërfshirëse ('zyrtarët policorë') dhe specifike ndaj gjinisë ('personeli ushtarak gra dhe burra').
- Të kërkohen këshilla nga ekspertët për çështje gjinore në hartimin dhe shqyrtimin e politikave të sigurisë.
- Të krijohet grupi gjinor, duke përfshirë parlamentarë femra dhe meshkuj, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për çështjet gjinore.
- Të ndërmerret vlerësimi i ndikimit në gjini i politikave aktuale dhe të propozuara të sigurisë.
- **Trajnimi me aspekt gjinor dhe mandatet për politikbërësit e sigurisë**
- T'u ofrohen parlamentarëve dhe stafit të tyre, posaçërisht atyre në komisionet e mbrojtjes dhe sigurisë, trajnime dhe forma tjera të ndërtimit të kapaciteteve për çështje gjinore dhe të sigurisë.
- Të sigurohet që çështjet gjinore të përfshihen në mandatin e komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë.

Të forcohet efikasiteti i institucioneve në sektorin e sigurisë

■ Iniciativat për të shtuar rekrutimin, ruajtjen dhe avancimin e grave brenda institucioneve të sektorit të sigurisë

- Të apelohej për objektiva specifike për rekrutimin dhe ruajtjen e grave.
- Të ndryshohen politikat dhe praktikën e resurseve njerëzore për një balanc më të mirë punë-jetë.
- Të autorizohen dhe ose kërkohet të dhëna të bazuara në seks lidhur me përfshirjen e gjinisë dhe përbërjen e institucioneve të sektorit të sigurisë.
- Të kërkohen analiza të rënies së numrit të femrave kadetë në akademi policore dhe ushtarake, si dhe gjatë fazave të mëvonshme të karrierës së tyre, dhe të monitorohen iniciativat për të shtuar mbajtjen e grave.

■ Trajnimi në çështjet gjinore për personelin e sektorit të sigurisë

- Të sigurohet që i tërë personeli i sektorit të sigurisë të

trajnohet në mënyrë adekuate në çështjet gjinore.

■ Legjislacion gjithëpërfshirës në GBV

- Të monitorohet zbatimi i përkushtimeve ndërkombëtare, rajonale dhe nacionale në eliminimin e GBV, duke përfshirë atë në institucionet e sektorit të sigurisë.
- Të zhvillohen legjislacion, politika dhe plane nacionale të veprimit për eliminimin e GBV, të cilat theksojnë përgjegjësitë specifike të zbatimit të ligjit, gjyqësisë dhe sistemit penal.

■ Institucionet e sigurisë dhe personeli të mbahen të përgjegjës për parandalimin dhe përgjigjen ndaj GBV

- Të sigurohen legjislacione dhe kode të sjelljes të qarta për përgjegjësinë e personelit të sektorit të sigurisë lidhur me parandalimin e brendshëm dhe përgjigjen ndaj shkeljeve të drejtave të njeriut, duke përfshirë procedurat disiplinore.
- Të monitorohen ankesat, hetimet dhe dënimet për shkeljet e të drejtave të njeriut nga personeli i sektorit të sigurisë.
- Të caktohen hulumtime/studime në natyrën dhe shtrirjen e ngacmimeve seksuale dhe formave tjera të GBV në institucionet e sektorit të sigurisë.

■ Ombudspersoni

- Të konsiderohet krijimi i pozitive, siç është ajo e Ombudspersonit me autorizime të veçanta në mbikëqyrjen e integritetit të çështjeve gjinore në institucionet e mbrojtjes dhe atyre të sektorit të sigurisë.
- Të sigurohet që zyra e ombudspersonit ka mandat dhe përvojë adekuate për të trajtuar GBV, duke përfshirë këtu njësitin për çështje gjinore apo ekspertë të çështjeve gjinore.

Të rritet përfaqësimi dhe pjesëmarrja e grave brenda parlamenteve

■ Të rritet përfaqësimi i grave në parlament

- Të zbatohen kuotat kushtetuese, legjislative apo ato vullnetare të partive, të reformohen sistemet elektorale dhe të ofrohet ndihmë dhe ndërtim i kapaciteteve për gratë candidate.
- Të ngritet vetëdija e përfaqësuesve të partive politike dhe publikut në përgjithësi, për rëndësinë e përfaqësimit të grave në politikë.

■ Komisionet e sigurisë dhe të mbrojtjes të bëhen më të balancuara nga aspekti gjinor

- Të kalohet legjislacioni i cili thërret për pjesëmarrje të shtuar të femrave parlamentare në komisionet që kanë të bëjnë me sigurinë (shih katrorin 2).
- Të konsiderohet krijimi i caqeve dhe kuotave strategjike për pjesëmarrjen e grave në të gjitha strukturat e komisioneve.

Katrori 2

Izrael: përfaqësimi i barabartë në vendimmarrje për politika të sigurisë⁴

Në vitin 2005, parlamenti Izraelit Knesset kaloi një amendament për ligjin e vitit 1956 për Përfaqësimin e Barabartë të Grave i cili mandatonte përfshirjen e grave në ekipet e emëruara për negociatat e paqes dhe përcaktimin e politikave vendore, të huaja, apo atyre të sigurisë. Dy anëtarë të parlamentit iniciuan ligjin në bashkëpunim me Isha L'isha, një organizatë bazë e grave. Me qëllim të kalimit të ligjit, një koalicion ad hoc i organizatave të grave dhe atyre për paqe u formua dhe u iniciua një fushatë e gjerë për media dhe lobim.

Të avancohet buxhetimi i barabartë dhe menaxhimi i resurseve

■ Buxhetimi i çështjeve gjinore

- Të ndërmerret auditimi me aspekt gjinor i buxheteve ekzistuese dhe atyre të propozuara për të siguruar fonde të cilat trajtojnë nevojat e sigurisë për gra, burra, djem dhe vajza.
- Të integrohen çështjet gjinore në buxhetet e propozuara.

■ Prokurimi i çështjeve gjinore dhe mbrojtjes

- Të sigurohet rezervim i fondeve për blerjen e uniformave dhe pajisjeve për gra, për ndërtesa të veçanta për gra dhe për nevojat e grave për shëndetin riproduktiv.
- Të sigurohet që rregulloret nacionale për tregti me armë ndalojnë tregtinë me regjimet ose individët që kryejnë GBV.

Po ashtu në dispozicion në Mjetin 7...

- Shembuj të formave të ndryshme të kuotave për gra
- Strategji praktike për trajtimin e GBV
- Metodat për buxhetimin e çështjeve gjinore

Sfidat dhe mundësitë në vendet e post-konfliktit

Në mjediset post-konfliktuale, roli mbikëqyrës i parlamentit është shpesh shumë i dobët. Megjithatë, parlamentet kanë mundësi të luajnë rol konstruktiv për të siguruar që çështjet gjinore janë të integruara në procesin e krijimit dhe ristrukturimit të institucioneve të sektorit të sigurisë.

Sfidat për integrimin e çështjeve gjinore

- Roli dhe autoriteti i parlamenteve mund të komprometohet ashpër, posaçërisht në raport me mbikëqyrjen e institucioneve të sigurisë siç është ushtria.
- Pasi që sektori i sigurisë është fushë shumë komplekse, jo të gjithë parlamentarët kanë njohuri të mjaftueshme apo përvojë për mbikëqyrje efektive, posaçërisht në kontekste post-konflikti.
- Parlamentarët dhe institucionet e sigurisë mund t'i shohin organizatat e shoqërisë civile si kundërshtarë politik dhe prandaj nuk janë të gatshëm të punojnë me organizatat e grave.
- Pjesëmarrja në politikë dhe në forcat e sigurisë mund të ketë asocim negativ për shkak të dhunës dhe shkeljeve të drejtave të njeriut në të kaluarën. Kjo mund ta vështirësoj shtimin e pjesëmarrjes së grave.
- Mund të ketë rezistencë në prioritizimin e çështjeve gjinore, siç është GBV, në rastet kur kërcënimet tjera të sigurisë shihen si çështje më të ngutshme.

Mundësitë për integrimin e çështjeve gjinore

- Parlamentet mund të avokojnë për përfshirjen e grave (siç janë femrat parlamentare) në negociatat për paqe dhe integrimin e çështjeve gjinore në marrëveshjet për paqe. Marrëveshjet për paqe shpesh shërbejnë si kornize për RSS.
- Mbikëqyrja e proceseve të çaromatimit, demobilizimit dhe re-integritetit mund të shërbejë si pikë hyrëse për të siguruar trajtim adekuat të nevojave të ish luftëtarëve meshkuj dhe femra.
- Autoriteti ligjvënës, mbikëqyrës dhe buxhetor i parlamentit i mundëson atij të ndikoj në reformat që i përgjigjen çështjeve

Afganistani ka ndryshuar prej një vendi ku të drejtat e grave kanë qenë të kufizuara ashpër në një vend i cili garanton barazinë gjinore para ligjit. Në fushën e përfaqësimit politik, kushtetuta e re garanton përfshirje formale të grave në proceset vendimmarrëse politike. Neni 83 përcakton se së paku dy kandidatet femra nga secila provincë duhet të zgjidhen për parlament. Kjo dispozitë kushtetuese u zbatua me sukses. Në zgjedhjet e shtatorit 2005, u zgjedhën 69 gra të cilat përfaqësonin rreth 27% nga 249 anëtarë të Wolesi Jirga.

Ngjashëm, kushtetuta e Irakut, e ratifikuar në tetor 2005 u garanton grave një çerek nga 275 vende sa ka parlamenti. Edhe në Irak u zbatuan kuotat kushtetuese. Pas zgjedhjeve të dhjetorit 2005, gratë përfaqësojnë një çerek të Përfaqësuesve të Këshillit nacional. Këto dy rezultate të zgjedhjeve janë të rëndësishme së veçantë në rajonin ku gratë vazhdojnë të jenë të nën përfaqësuara në vendim marrjen politike dhe në disa instanca nuk gëzojnë as të drejta të plota të shtetësisë.

gjinore në sistemet penale dhe atyre të drejtësisë.

- Proceset e RSS ju ofrojnë parlamentarëve mundësin për të siguruar që çështjet gjinore siç është GBV të trajtohen dhe të ndërmerren iniciativa specifike për rekrutimin e grave.
- Transformimi post-konflikt i politikave elektorale dhe i vetë parlamentit ofron mundësi për zbatimin e masave për shtimin e përqindjes së femrave parlamentare (duke përfshirë atë në komisionet e mbrojtjes dhe sigurisë) dhe ndërtimin e mekanizmave për konsultim me organizatat e shoqërisë civile.
- Donatorët mund të jenë të gatshëm të përkrahin reformat që i përgjigjen çështjeve gjinore duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të femrave dhe meshkujve parlamentarë.

Pyetjet për mbikëqyrjen parlamentare

Pyetjet kyçe që mbesin kur kemi të bëjmë me vlerësimin se a janë apo nuk janë të integruara çështjet gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë, janë:

- A kanë marrë parlamentarët e komisioneve të sigurisë dhe mbrojtjes ndërtim të kapaciteteve në çështje gjinore, siç

janë trajnimet apo udhëzime për çështje gjinore?

- A janë të gatshme strukturat formale dhe joformale për konsultime me organizatat e shoqërisë civile lidhur me çështjet e sigurisë, duke përfshirë organizatat e grave?
- Cili është përfaqësimi i femrave dhe meshkujve parlamentarë në komisionet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë?
- A është themeluar zyra e ombudspersonit dhe a ka mandat dhe kapacitet për të trajtuar çështjet gjinore?
- A ekzistojnë iniciativa për të shtuar përfaqësimin e grave në parlament, siç janë sistemet e kuotave apo mbështetje femrave kandidatë?
- A është nxjerrë legjislacion i cili garanton pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë të grave dhe burrave brenda institucioneve të sigurisë? A ka legjislacion adekuat për GBV?
- A është themeluar grupi i grave/çështjeve gjinore? A diskutohen çështjet e sigurisë brenda këtij grupi?
- A janë aplikuar analizat buxhetore të çështjeve gjinore në buxhetet që kanë të bëjnë me sigurinë?

Informata shtesë

Burimet

Byanyima, W. and Wehner, J. - **Parlamenti, Buxheti dhe Gjinia – Doracak i IPU për Parlamentarët N° 6**, 2004.

Born, H., Fluri, P. and Johnson, A. eds. – **Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë: Parimet, Mekanizmat dhe Praktikrat**, DCAF dhe IPU, 2003 (i gatshëm në 40 gjuhë).

Freeman, M. – **Si të Funkcionoj Pajtimi: Roli i Parlamenteve – Doracak i IPU për Parlamentarët N° 10**, 2005.

Organizatrat

Asociacioni i Parlamentarëve Evropian për Afrikë (AWEPA) – www.awepa.org

iKNOW Politics: Rrjeti Ndërkombëtarë i Dijes për Gratë në Politikë - www.iknowpolitics.org

Iniciativa për Siguri Gjithëpërfshirëse - www.huntalternatives.org/pages/7_the_initiative_for_inclusive_security.cfm

Instituti Ndërkombëtarë për Demokraci dhe Mbështetje Elektorale - www.idea.int

Unioni Ndërkombëtarë Parlamentarë – www.ipu.org

Mjet Praktik mbi Gjinië dhe RSS

1. Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 2. Reforma Policore dhe Gjinia
 3. Reforma Gjinore dhe Gjinia
 4. Reforma e Drejtësisë dhe Gjinia
 5. Reforma Penale dhe Gjinia
 6. Menaxhimi i Kufijve dhe Gjinia
 7. Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 8. Politik-Bërja e Sigurisë Nacionale dhe Gjinia
 9. Mbikëqyrja e Shoqërisë Civile e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 10. Ushtritë Private dhe Kompanitë e Sigurimit dhe Gjinia
 11. Vlerësimi i RSS, Monitorimi dhe Evaluimi, dhe Gjinia
 12. Trajnimi Gjitor për Personelin e Sektorit të Sigurisë
- Shtojcë mbi Ligjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare dhe Rajonale

Secili nga këto Mjete dhe Shënime Praktike mund të gjenden në: www.dcaf.ch, www.un-instraw.org dhe www.osce.org/odihr.

Ky Shënim Praktik është përgatitur nga Mugiho Takeshita - DCAF, bazuar në Mjetin 7, autor i të cilit është Ilja Luciak.

¹ DCAF and IPU, Parliamentary Oversight of the Security Sector: Principles, Mechanisms and Practices, DCAF and IPU, 2003, p. 22. <http://www.dcaf.ch/oversight/publications.cfm?navsub1=12&navsub2=3&nav1=3>

² IPU, Women in National Parliaments, 31 Oct. 2007. <http://www.ipu.org/wmn-e/world.htm>

³ Anderlini, S.N. and Conaway, C.P., Negotiating the Transition to Democracy and Reforming the Security Sector: The Vital Contributions of South African Women, (Initiative for Inclusive Security: Washington DC), 2004, pp.17-18; 23-25.

⁴ Isha L'Isha News Release (21 July 2005), Parliament/Knesset Passes New Law Mandating Inclusion of Women for Peace and Security Negotiations & Policy. <http://www.peacewomen.org/news/Israel-OPT/July05/Knesset.html>

⁵ IPU, Women in Politics. <http://www.ipu.org/wmn-e/suffrage.htm>; Mosadiq, The New Afghan Constitution